



BANKA QENDRORE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS
CENTRALNA BANKA REPUBLIKE KOSOVA
CENTRAL BANK OF THE REPUBLIC OF KOSOVO

DRAFT PASQYRAT FINANCIARE TË BQK-së
/për/deri tremujorin e tretë 2020/
-Raport i ndërmjetëm i paaudituar-

Departamenti për Planifikim dhe Raportim Financiar

Pasqyrat financiar të BQK-së për tremujorin e tretë 2020

E përcaktuar me Ligjin 03/L-209 “Mbi Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës” (me iniciale BQK), si kornizë raportuese për përgatitjen e pasqyrave financiare janë Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar, përkatësisht nenit 58 të Ligjit të përmendur më lartë. Këto pasqyra për tremujorin e tretë përfshijnë *pasqyrën e gjendjes financiare dhe llogarinë e përmbledhur të të ardhurave, pasqyrën e ndryshimeve në kapital dhe rezerva (ekuitet)*. Viti financiar i BQK-së përputhet me vitin kalendarik, si rrjedhojë, data e raportit për pasqyrat financiare të tremujorit të tretë 2020 është 30 shtator 2020.

Shkurtesa të përdorura në raport:

BQK – Banka Qendrore e Republikës së Kosovës

FMN – Fondi Monetar Ndërkombëtar

DST (SDR) – Të Drejtat Speciale të Tërheqjes

SNP – Sistemi ndërbankar i pagesave

BQE (ECB) – Banka Qendrore Evropiane

USD – Dollar Amerikan

Pasqyra e gjendjes financiare

sipas të dhënave me:

	Shënim	30 shtator 2020	31 dhjetor 2019
Mjetet			
Paraja e gatshme	5	274,797,205.58	302,165,654.19
Llogaritë rrjedhëse	6	189,025,105.74	108,863,319.55
Letrat me vlerë	7	598,085,104.02	576,616,063.03
Plasmanët në tregun e parasë	8	197,998,403.48	248,863,945.56
Mjetet e ndërlidhura me FMN	9	288,884,665.46	298,344,638.07
Prona dhe pajisjet	10	4,843,477.22	4,966,830.97
Mjetet e paprekshme	11	1,764,999.68	1,945,259.86
Mjete tjera	12	1,457,720.28	1,699,894.95
Gjithsej mjetet		1,556,856,681.46	1,543,465,606.18
Detyrimet			
Ndaj bankave komerciale në vend	13	457,502,917.27	414,941,602.21
Ndaj llogarive të ndërlidhura me FMN	14	289,468,652.54	297,235,801.64
Ndaj institucioneve qeveritare	15	651,268,004.13	719,819,361.54
Ndaj institucioneve publike dhe komerciale	16	97,902,846.40	52,166,681.06
Nga huamarrja/et	17	2,266,259.07	2,266,259.07
Detyrime tjera vendore	18	1,405,959.95	1,778,735.30
Gjithsej detyrimet		1,499,814,639.36	1,488,208,440.82
Kapitali dhe rezervat			
Kapitali i autorizuar	19	30,000,000.00	30,000,000.00
Fondet rezervë	20	25,257,165.36	23,148,464.17
Neto rezultati i periudhës		1,784,876.74	2,108,701.19
Gjithsej kapitali dhe rezervat		57,042,042.10	55,257,165.36
Gjithsej detyrimet, kapitali dhe rezervat		1,556,856,681.46	1,543,465,606.18

Shënimet prej faqes 6 deri 17 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Këto pasqyra financiare janë vetëm draft raport për publikim preliminar, pasi si të tilla ato janë në proces të miratimit nga Bordi i Bankës Qendrore. Këto draft pasqyra financiare do të ri publikohen pas miratimit nga Bordi i BQK-së.


 Fehmi Mehmeti
 Guvernator


 Faton Ahmetaj
 Drejtor për Planifikim dhe
 Raportim Financiar

Pasqyra e përmbledhur e të ardhurave

	Shënim	30 shtator 2020	30 shtator 2019
Të hyrat nga interesi (kamata)			
Të hyrat nga interesi		2,786,969.38	2,539,436.43
Shpenzimet nga interesi		(650,674.18)	(1,075,799.53)
Neto të hyrat nga interesi	21	2,136,295.20	1,463,636.90
Të hyrat nga tarifatat dhe ndalesat			
Të hyrat nga tarifatat dhe ndalesat		1,878,391.27	2,032,056.35
Shpenzimet nga tarifatat dhe ndalesat		(248,749.77)	(367,724.39)
Neto të hyrat nga tarifatat dhe ndalesat	22	1,629,641.50	1,664,331.96
Të hyrat nga aktiviteti rregullator dhe të hyra tjera operative			
Të hyrat nga aktiviteti rregullator	23	3,582,961.69	3,357,184.16
Të hyrat nga grantet	24	94,206.93	86,356.87
Të hyrat tjera operative	25	6,450.26	2,927.55
Të ardhurat operative (21+22+23+24+25)		7,449,555.58	6,574,437.44
Shpenzimet administrative			
Shpenzimet për personelin	26	(3,312,790.30)	(3,286,820.91)
Zhvlerësimi dhe amortizimi	10,11	(768,796.21)	(771,498.58)
Shpenzime të përgjithshme administrative	27	(849,798.48)	(911,237.20)
Shpenzimet administrative¹		(4,931,384.99)	(4,969,556.69)
Neto rezultati pa efektin e kursit të këmbimit dhe para pritjeve për humbjet kreditore		2,518,170.59	1,604,880.75
Neto fitimi/(humbja) nga kursi i këmbimit valutor	28	(358,820.85)	563,412.75
Provizioni për humbjet e pritura kreditore (neto rritja/(zvogëlimi)		(374,473.00)	-
Neto rezultati i periudhës		1,784,876.74	2,168,293.50

Shënimet prej faqes 6 deri 17 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare

¹ Gjithsej shpenzimet operative = shpenzimet administrative + shpenzimet nga tarifatat dhe ndalesat.

Pasqyra e ndryshimeve në ekuitet (kapital dhe rezerva)

	Kapitali	Fondi rezervë	Rezervat e rivlerësimit	Fitimet e mbajtura	Neto Rezultati	Gjithsej
Gjendja më 1 janar 2019	30,000,000.00	21,213,678.78	-	1,934,785.39	-	53,148,464.17
Transferimi në fondin rezervë	-	1,407,889.59	526,895.80	(1,934,785.39)	-	-
Gjithsej transaksionet e kërkuara me ligj	-	1,407,889.59	526,895.80	(1,934,785.39)	-	-
Fitimi për vitin	-	-	-	-	2,108,701.19	2,108,701.19
Të ardhurat tjera gjithëpërfshirëse	-	-	-	-	-	-
Gjithsejtë të ardhurat gjithëpërfshirëse për vitin	-	-	-	-	2,108,701.19	2,108,701.19
Gjendja më 31 dhjetor 2019	30,000,000.00	22,621,568.37	526,895.80	-	2,108,701.19	55,257,165.36
Gjendja më 1 janar 2020	30,000,000.00	22,621,568.37	526,895.80	2,108,701.19	-	55,257,165.36
Transferimi në fondin rezervë	-	-	-	-	-	-
Gjithsej transaksionet e kërkuara me ligj	-	-	-	-	-	-
Fitimi për vitin	-	-	-	-	1,784,876.74	1,784,876.74
Të ardhurat tjera gjithëpërfshirëse	-	-	-	-	-	-
Gjithsejtë të ardhurat gjithëpërfshirëse për vitin	-	-	-	-	1,784,876.74	1,784,876.74
Gjendja më 30 shtator 2020	30,000,000.00	22,621,568.37	526,895.80	2,108,701.19	1,784,876.74	57,042,042.10

Shënimet prej faqes 6 deri 17 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Pasqyrat financiare të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës

1. Institucioni Raportues

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës - BQK, e cila operon sipas Ligjit nr. 03/L-209“Mbi Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës” të aprovuar në korrik të vitit 2010.

2. Baza e përgatitjes së pasqyrave financiare

Korniza Raportuese

Pasqyrat financiare janë përgatitur sipas kërkesave të Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF).

Baza e përgatitjes

Pasqyrat financiare janë të përgatitura në bazë të kostos historike dhe të harmonizuara sipas kërkesave të Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF).

Valuta e funksionale dhe e prezantuar

Këto pasqyra financiare janë të prezantuara në EURO, që është valutë zyrtare funksionale e Kosovës. Në rast se vlerat janë të shprehura në valuta tjera atëherë do të këtë shënim përkatës aty ku janë të paraqitura ato.

3. Politikat kontabël

Pasqyrat financiare janë të përgatitura duke shfrytëzuar konsistencën e politikave kontabël, krahasuar me 31 dhjetor 2019 nuk ka pasur ndryshim për tu theksuar ne politikat kontabël, ndërsa krahasuar me 30 shtator 2019 ka një plotësim ne politikat kontabël duke ju referuar kërkesave të standardit ndërkombëtar për raportim financiar (SNRF/IFRS 9) nr.9. Përkatësisht aplikimi i humbjeve të pritura kreditore.

4. Menaxhimi i rrezikut financiar

Rreziku financiar në BQK është i paraqitur në formën e: rrezikut të likuiditetit, rrezikut operacional, rrezikut kreditor dhe rrezikut të tregut. Rreziku financiar në BQK ndërlidhet kryesisht me punët e menaxhimit të mjeteve dhe menaxhohet nga Departamenti i Menaxhimit të Mjeteve në përputhje me politikën e menaxhimit të mjeteve të aprovuar nga Bordi i BQK-së. Mjetet e ekspozuara nga aktiviteti i menaxhimit financiar të tyre janë kryesisht në shtete të Bashkimit Evropian me vlerësim kreditor të investueshëm (prej AAA deri BBB+/- Aaa deri Baa1).

Menaxhimi i Rrezikut të Likuiditetit (vazhdim)**Vlerat bartëse sipas maturitetit të mbetur**

	Shënim	Neto vlera e bartur	më pak se 3 muaj	3-6 muaj	6 muaj - 1 vit	1 - 5 vite	mbi 5 vite
30 shtator 2020							
Mjetet							
Paratë e gatshme	5	274,797,205.58	274,797,205.58	-	-	-	-
Llogaritë rrjedhëse	6	189,025,105.74	189,025,105.74	-	-	-	-
Letra me vlerë	7	598,085,104.02	9,706,531.90	19,693,335.54	43,994,397.20	524,690,839.37	-
Plasmanët në tregun e parasë	8	197,998,403.48	148,168,403.48	-	49,830,000.00	-	-
Mjetet e ndërlidhura me FMN	9	288,884,665.46	175,498,995.46	16,124,960.00	23,804,228.00	73,456,482.00	-
		1,548,790,484.28	797,196,242.16	35,818,295.54	117,628,625.20	598,147,321.37	-
Detyrimet							
Ndaj bankave vendore	13	(457,502,917.27)	(457,502,917.27)	-	-	-	-
Ndaj llogarive të ndërlidhura me FMN	14	(289,468,652.54)	(176,082,982.54)	(16,124,960.00)	(23,804,228.00)	(73,456,482.00)	-
Ndaj institucioneve qeveritare	15	(651,268,004.13)	(651,268,004.13)	-	-	-	-
Ndaj institucioneve publike dhe komerciale	16	(97,902,846.40)	(97,902,846.40)	-	-	-	-
Nga huamarrja / et	17	(2,266,259.07)	-	-	-	(1,019,816.58)	(1,246,442.49)
Detyrime tjera vendore	18	(1,405,959.95)	(1,405,959.95)	-	-	-	-
		(1,499,814,639.36)	(1,384,162,710.29)	(16,124,960.00)	(23,804,228.00)	(74,476,298.58)	(1,246,442.49)
		48,975,844.92	(586,966,468.13)	19,693,335.54	93,824,397.20	523,671,022.79	(1,246,442.49)
31 dhjetor 2019							
Mjetet							
Paratë e gatshme	5	302,165,654.19	302,165,654.19	-	-	-	-
Llogaritë rrjedhëse	6	108,863,319.55	108,863,319.55	-	-	-	-
Letra me vlerë	7	576,616,063.03	100,349.13	16,351,350.90	15,092,118.50	542,405,182.97	2,667,061.54
Plasmanët në tregun e parasë	8	248,863,945.56	9,079,945.56	20,000,000.00	219,784,000.00	-	-
Mjetet e ndërlidhura me FMN	9	298,344,638.07	174,416,764.07	20,917,270.00	37,493,512.00	65,517,092.00	-
		1,534,853,620.40	594,626,032.50	57,268,620.90	272,369,630.50	607,922,274.97	2,667,061.54
Detyrimet							
Ndaj bankave vendore	13	(414,941,602.21)	(414,941,602.21)	-	-	-	-
Ndaj llogarive të ndërlidhura me FMN	14	(297,235,801.64)	(173,307,927.64)	(20,917,270.00)	(37,493,512.00)	(65,517,092.00)	-
Ndaj institucioneve qeveritare	15	(719,819,361.54)	(719,819,361.54)	-	-	-	-
Ndaj institucioneve publike dhe komerciale	16	(52,166,681.06)	(52,166,681.06)	-	-	-	-
Nga huamarrja / et	17	(2,266,259.07)	-	-	-	(906,503.63)	(1,359,755.44)
Detyrime tjera vendore	18	(1,778,735.30)	(1,778,735.30)	-	-	-	-
		(1,488,208,440.82)	(1,362,014,307.75)	(20,917,270.00)	(37,493,512.00)	(66,423,595.63)	(1,359,755.44)
		46,645,179.58	(767,388,275.25)	36,351,350.90	234,876,118.50	541,498,679.34	1,307,306.10

5. Paraja e gatshme

	30 shtator 2020	31 dhjetor 2019
Paraja e gatshme	274,797,205.58	302,165,654.19
Gjithsej	274,797,205.58	302,165,654.19

Vërehet një rënje e saldos me 30 shtator 2020 krahasuar më 31 dhjetor 2019. Kryesisht e rrjedhe nga operacionet ditore me para të gatshme por që është brenda përkufizimeve të aktivitetit.

6. Llogaritë rrjedhëse (nostro - me bankat jo rezidente)

Përbërja e llogarive rrjedhëse me banka jo vendore është si më poshtë:

	30 shtator 2020	31 dhjetor 2019
Deutsche Bundesbank	104,155,981.53	71,229,677.64
Raiffeisen Zentralbank	9,929,528.68	9,899,653.64
Banque centrale du Luxembourg	49,683,538.14	1,827,093.20
Deutsche Bank	24,607,747.04	24,169,294.02
Nostro Acc. Commerzbank AG	459,903.97	499,454.00
Nostro Acc. Bayerische Landesbank	9,912.76	989,992.72
Nostro acc. with FED	178,493.62	248,154.33
Gjithsej	189,025,105.74	108,863,319.55

Pozicioni i *llogarive rrjedhëse* (nostro) krahasuar më 31 dhjetor 2019 është rritur, ndryshimi është si rezultat i maturimit të njërit plasman në formë të depozitës me mundësi thirrje/tërheqje (Call Deposits) në vlerë 80 milion euro në Deutsche Bank. Ndërsa ndryshimi në llogaritë rrjedhëse tjera është rrjedhë e aktivitetit të këtyre llogarive dhe e menaxhimit të portofolios së mjeteve e efektuar edhe nga normat negative në tregjet financiare (përkatësisht shënimeve 5, 6, 7 dhe 8, që janë shumë ngushtë të lidhura njëra me tjetrën referuar nga aspekti i menaxhimit të mjeteve). Rritja në këtë grup mund të ketë efekt në rritjen e shpenzimeve të interesit² nga normat negative që bankat korrespondente (përfshirë këtu llogarinë me FED – Federal Reserve) aplikojnë në llogaritë e shpalosura më lartë.

7. Letrat me Vlerë (Bonot e thesarit dhe obligacionet qeveritare)

Të dy kategoritë që bëjnë pjesë në kuadër të grupit nën shënimin 7 janë letra të borxhit të lëshuara (emetuara) nga vende dhe institucione të ndryshme të Evropës, në analitikë shpërndarja gjeografike është sipas listimit në faqe 9 (në tabelën *sipas shpërndarjes gjeografike*). Bonot e Thesarit të shpalosura po ashtu në faqe 9, kanë maturitet të kontraktuar deri në një vit. Ndërsa ato të obligacioneve qeveritare kanë maturitet të kontraktuar deri në pesë vite. Të gjitha janë në Euro dhe kanë norma të interesit efektiv që lëvizin nga 0.019% deri 3.021% vjetore në vitin 2020 (në vitin 2019 periudha e njëjtë raportuese: 0.019% deri në 3.021% vjetore).

² Për periudhën janar – shtator kemi paguar diku rreth 514 mijë euro interesa nga saldot e rrjedhëse të llogarive me bankat korrespondente apo mesatarisht rreth 57 mijë euro në muaj (e gjitha e paraparë në kuadër të buxhetit 2020).

Letrat me vlerë sipas shpërndarjes gjeografike dhe llojit:**Letra me vlerë (sipas shpërndarjes gjeografike):**

	Neto vlera e bartur 30 shtator 2020	Neto vlera e bartur 31 dhjetor 2019
Gjermani	66,154,803.20	66,591,593.86
Francë	10,010,350.32	10,014,287.15
Holandë	12,342,257.21	12,544,329.74
Slloveni	20,687,852.05	21,415,801.24
Luksemburg	88,346,971.97	89,232,638.17
EuroFima-Switzerland (Zvicër)	5,823,530.50	5,821,687.15
KommuneKredit (Danimarkë)	6,038,564.44	6,046,542.85
Austria	77,096,228.28	77,029,414.23
Irlandë	103,198,349.55	104,240,670.70
Kosovë	208,386,196.49	183,679,097.94
Gjithsej	598,085,104.02	576,616,063.03

Letra me vlerë (sipas llojit):

	Neto vlera e bartur 30 shtator 2020	Neto vlera e bartur 31 dhjetor 2019
Bonot e thesarit	-	149,932.98
Obligacione	598,085,104.02	576,466,130.06
Gjithsej	598,085,104.02	576,616,063.03

Në kuadër të grupit vërehet një rritje e pozicionit krahasuar me periudhën 31 dhjetor 2019 që është rrjedhë normale e menaxhimit të portfolios, kryesisht e bazuar në sigurinë dhe likuiditetin e tyre dhe pastaj edhe në mundësitë për norma më optimale të kthimit të mjeteve.

8. Plasmanët në tregun e parasë (me bankat jo rezidente)

Në kuadër të këtij grupimi bëjnë pjesë plasmanët në tregun e parasë në bankat tona korrespondente. Norma e kamatës për këto plasmane deri në tremujorin e tretë 2020 mesatarisht është rreth 0.138% (minimum: -0.590% dhe maksimum: 1.500%), ndërsa në vitin 2019: në mesatare prej 0.366% (minimum: 0% dhe maksimum: 5.37%). Këto plasmane kryesisht kanë maturitet të kontraktuar deri në një vit. Analitika sipas bankave është e shpalosur në tabelën si më poshtë:

Plasmanët në tregun e parasë sipas bankave:	Neto vlera e bartur 30 shtator 2020	Neto vlera e bartur 31 dhjetor 2019
Deutsche Bank	139,440,000.00	239,784,000.00
Raiffeisen Bank International AG	49,830,000.00	-
FED New York	8,728,403.48	9,079,945.56
Gjithsej	197,998,403.48	248,863,945.56

Nëse e shohim 30 shtator 2020 ka një rënje krahasuar me 31 dhjetor 2019 dhe kryesisht e rrjedhë nga maturimi i njërit plasman në formë të depozitës me mundësi thirrje/tërheqje (Call Deposits) në vlerë 80 milion euro në Deutsche Bank dhe nga ndryshimi i kursit të këmbimit EUR/USD. Plasmanët aktive në euro në datën e raportimit janë 189 milion nga të cilave 139 milion në Deutsche Bank janë plasmanë në formë të depozitës me mundësi thirrje/tërheqje

(Call Deposits) me maturitet të pacaktuar mirëpo për te cilat është përdor opsioni i thirrjes dhe të njëjtat maturojnë në muajin tetor të këtij viti, ndërsa në RBI 50 milion euro janë me maturitet një vjeçar. Po ashtu kemi edhe një plasmanë prej 10.3 milionë në USD (me FED New York) të afatizuar në datën e raportimit (në tabelën e plasmanëve) është e shprehur kundërvlera në euro.

9. Mjetet e ndërlidhura me FMN

	30 shtator 2020	31 dhjetor 2019
Kuota me FMN	99,304,507.78	102,083,693.80
Depozitat në DST (SDR)	59,792,086.90	63,116,223.40
Kamata akruale	277,440.01	534,789.34
Përdorimi/huazimi i fondeve të FMN-së (SBA dhe RFI)	129,510,630.77	132,609,931.53
Gjithsej	288,884,665.46	298,344,638.07

Zërat më lartë rrjedhin nga anëtarësimi i Kosovës në FMN. Kuota në FMN paraqet vlerën e kuotës së obligueshme (82,600,000 SDR nga muaji shkurt 2016; ndërsa fillimisht ka qenë 59,000,000 SDR) që i është përcaktuar Kosovës nga FMN-ja e shprehur në euro.

Depozitat në DST (SDR) paraqet fillimisht vlerën e depozituar në DST në emër të Republikës së Kosovës sipas vendimeve të Bordit të Guvernatorëve të FMN-së më 28 gusht 2009 (43,737,278 SDR) dhe 9 shtator 2009 (11,631,135 SDR) e ndryshuar për transaksionet – të hyrat dhe shpenzimet e interesit dhe pagesat në emër të rritjes së kuotës po ashtu të shprehura në euro në tabelën më lartë.

Depozitat në DST – Të Drejtat Speciale të Tërheqjes (Special Drawing Rights – SDR) janë depozita që sjellin interes mesatarisht prej 0.240% për periudhën raportuese janar - shtator 2020 (ndërsa për janar – shtator 2019, 1.062%).

Zëri përdorimi i fondeve të FMN-së paraqet mjetet e huazuara nga FMN-ja sipas marrëveshjeve aktive për shfrytëzim të linjës kreditore (SBA) dhe marrëveshjes për ndihmën emergjente në kuadër të instrumentit të financimit të shpejtë (RFI) në vlerë 41.3 milion SDR 10 prill 2020.

10, 11 Mjetet e prekshme dhe të paprekshme

Kategoria e Mjeteve Themelore	Kosto Historike	Zhvlerësimi/ Amortizimi i Akumuluar deri më 31 dhjetor 2019	Zhvlerësimi/ Amortizimi i akumuluar i vitit deri me 30 shtator 2020	Gjithsej Zhvlerësimi/ Amortizimi i akumuluar 30 shtator 2020	Vlera Neto më 30 shtator 2020
<i>Prona, ndërtesat dhe pajisjet</i>	11,056,154.78	5,747,393.12	467,215.53	6,212,677.56	4,843,477.22
Pajisje, zyra dhe tjera	2,656,598.13	2,078,728.53	126,950.68	2,206,003.40	450,594.73
Automjetet	389,349.16	324,166.54	10,976.15	335,142.45	54,206.71
Ndërtesa	5,314,296.44	1,417,800.90	202,979.61	1,620,780.51	3,693,515.93
Pajisjet kompjuterike	2,303,476.49	1,926,697.15	126,309.09	2,050,751.20	252,725.29
Investime në proces	392,434.56	-	-	-	392,434.56
<i>Mjetet e Paprekshme</i>	4,643,210.49	2,576,633.44	301,580.68	2,878,210.81	1,764,999.68
Aplikacionet kompjuterike	4,079,055.49	2,576,631.88	301,580.68	2,878,210.81	1,200,844.68
Aplikacione në proces	564,155.00	-	-	-	564,155.00
<i>Gjithsej</i>	15,699,365.27	8,324,025.00	768,796.21	9,090,888.37	6,608,476.90

12. Mjetet tjera

Mjetet tjera përbëhen si më poshtë:

	30 shtator 2020	31 dhjetor 2019
Të hyra akruale	1,211,109.09	1,557,794.18
Parapagime	247,057.09	142,100.77
Pagesa/Kërkesa në proces (SNP/DepoX)	(445.90)	-
Gjithsej	1,457,720.28	1,699,894.95

Kërkesat ne proces do të shlyhen pasi sistemi DepoX të ekzekuton pagesat ne ditën e parë të punës. Apo varësisht nga procesi rregullohen brenda disa ditëve të punës.

13. Detyrimet ndaj bankave në vend

	30 shtator 2020	31 dhjetor 2019
ProCredit Bank - Kosovë	53,112,034.47	55,951,663.45
Raiffeisen Bank - Kosovë	82,039,386.39	60,931,328.15
NLB Prishtina	85,768,906.93	81,661,777.01
Komercijalna Banka - Dega Mitrovicë	8,546,179.69	7,623,490.77
Banka Ekonomike e Prishtinës	21,593,417.69	41,843,659.37
Banka për Biznes	52,966,004.83	42,068,526.87
Banka Kombëtare Tregtare e Shqipërisë	59,810,066.58	40,778,607.06
Turk Ekonomi Bankasi Sh.A	60,196,522.75	54,878,104.66
Turkiye Is Bankasi A.S.	18,725,728.77	19,307,459.16
T.C. Zirat Bankasi A.S.Dega Kosovë	6,744,402	9,896,928.39
Banka Kreditore e Prishtinës	267.76	57.32
Banka Credins Kosove	8,000,000.00	-
Gjithsej	457,502,917.27	414,941,602.21

Të shpalosura në këtë grup janë saldot e bankave komerciale që operojnë në vend (Kosovë). Këtë vit Bordit Ekzekutiv i BQK-se ka bërë miratimin e kërkesës nga subjekti “Banka Credins Kosovë” për licencim si banke ne Republikën e Kosovës. Sipas rregullativës ligjore bankat komerciale duhet të mbajnë mjetet për rezervën e likuiditetit në BQK. Në total shuma e shpalosur më lartë për periudhën raportuese 30 shtator 2020 është rreth 2.56 herë më e lartë se sa minimumi i rezervës së obliguar që duhet mbajtur në BQK.

14. Detyrimet ndaj llogarive të ndërlidhura me FMN

	30 shtator 2020	31 dhjetor 2019
Llogaria rrjedhëse FMN Nr. 1	254,272.44	255,209.23
Llogaria shpenzimeve FMN Nr. 2	6,011.17	6,179.40
Llogaria e FMN-së, në përkujdesje	204,438,045.90	209,640,482.49
Pjesa e paguar e Kuotës te FMN-ja	17,926,152.79	18,363,463.67
Alokime nga FMN-ja në formë të DST	66,565,774.81	68,428,718.15
Kamata akruale	278,395.43	541,748.70
Gjithsej	289,468,652.54	297,235,801.64

Zërat më lartë paraqesin pozicionet e llogarive të ndërlidhura me FMN-në që kanë rrjedhur pas anëtarësimit të Kosovës në FMN.

Të tre zërat e parë (tabela nën shënim 14) paraqesin llogari të hapura sipas rregullativës së FMN-së, dy janë llogari operative dhe një është llogari në përkujdesje për letrat me vlerë që Qeveria e Kosovës i ka lëshuar si nota të pagueshme ndaj FMN-së.

Pjesa e paguar e kuotës, ka të përfshirë edhe interesin e paguar nga IMF për këtë zë, sipas rregullativës së FMN-së, e cila në tabelë nën shënim 14 është e shprehur në euro.

Alokimet në formë të Drejtave Speciale të Tërheqjes (DST/SDR) në FMN, përbehen nga alokimet e përmendura në *shënimin 9* më 28 gusht dhe 9 shtator 2009, të cilat së bashku gjithsej arrijnë vlerën prej 55,368,413 DST (SDR) po ashtu të shprehura në euro në tabelën e shënimit 14. Norma e interesit për zërin e alokimeve për periudhën raportuese është e njëjtë sikurse te depozitat DST (SDR).

15. Detyrimet ndaj institucioneve qeveritare

Detyrimet ndaj institucioneve qeveritare kanë këtë përbërje:

Llogarit rrjedhëse

	30 shtator 2020	31 dhjetor 2019
Thesari – Ministria e Financave	433,887,250.97	444,301,083.98
Agjencia Kosovare për Privatizim	217,147,286.35	275,159,950.46
Institucionet e përkohshme administrative	233,466.81	358,327.10
Gjithsej (llogari rrjedhëse)	651,268,004.13	719,819,361.54

Depozitat në llogari rrjedhëse përfitojnë kamatë prej 0.00% (si për periudhën raportuese, ashtu edhe për periudhën krahasuese). Afatizime aktive në periudhën raportuese nuk ka, po ashtu edhe për vitin 2019, përkatësisht më 31 dhjetor 2019 nuk ka pasur afatizime aktive. Ndryshimi është rrjedhë e aktivitetit operativ të institucioneve që përbëjnë grupin.

16. Detyrimet ndaj institucioneve publike dhe komerciale

Detyrimet ndaj institucioneve publike dhe komerciale të paraqitura në vijim të gjitha janë mjete në llogari rrjedhëse:

	30 shtator 2020	31 dhjetor 2019
Kompanitë e sigurimeve	4,772,917.94	4,717,094.16
Institucione dhe kompani publike	93,128,218.63	47,447,861.07
Fondet e pensioneve dhe tjera	1,709.83	1,725.83
Gjithsej	97,902,846.40	52,166,681.06

Ka një rritje krahasuar me periudhën 31 dhjetor 2019, që i atribuohet tërësisht grupit të institucioneve dhe kompanive publike. Me saktësisht, kryesisht nga mjetet e FKPK – Fondi i Kursimeve Pensionale të Kosovës që këta mbajnë në llogarinë me BQK.

17. Detyrimet nga Huamarrja/et

	30 shtator 2020	31 dhjetor 2019
Huamarrje nga Banka Botërore	2,266,259.07	2,266,259.07
Gjithsej	2,266,259.07	2,266,259.07

Kemi dy projekte që janë financuar nga Banka Botërore përmes kredisë: projekti për *Planin e vazhdimësisë së punës* dhe projekti për *Sistemin e pagesave në kohë reale* (RTGS). Projekte këto të implementuara në vitin 2016. Kthimi i mjeteve është me afat mbi 10 vjet.

18. Detyrime tjera

	30 shtator 2020	31 dhjetor 2019
Llogari në përkujdesje	756,036.51	756,036.51
Të hyrat e shtyra	330,459.65	404,396.62
Llogari të pagueshme dhe shpenzime akruale	319,463.79	618,302.17
Gjithsej	1,405,959.95	1,778,735.30

Në kuadër të grupit vërehet zvogëlim i lehtë në gjithsej saldon e grupit krahasuar më 31 dhjetor 2019. Kryesisht i ndikuar nga zvogëlimi i saldosh të llogarive të pagueshme dhe shpenzime akruale dhe pjesërisht nga saldo e të hyrave të shtyra më 30 shtator 2020, krahas asaj më 31 dhjetor 2019.

19, 20. Kapitali i autorizuar dhe Rezervat**Kapitali dhe Rezervat e Përgjithshme**

	30 shtator 2020	30 dhjetor 2019
Kapitali i autorizuar	30,000,000.00	30,000,000.00
Fondet Rezervë	25,257,165.36	23,148,464.17
Rezultati neto i periudhës	1,784,876.74	2,108,701.19
Gjithsej	57,042,042.10	55,257,165.36

Rezultati financiar i periudhës është pozitiv për rreth 1.785 milion euro, i ndikuar kryesisht nga realizimi i kënaqshëm për të hyrat dhe mbajtja e shpenzimeve sipas planifikimit buxhetor për periudhën raportuese. Zëri i rivlerësimit valutator në datën e raportimit është në vlerë prej rreth 359 mijë euro (si humbje e porealizuar), zëri i provizioneve për humbjet e pritura kreditore (neto rritja/(zvogëlimi) është në vlerë 374 mijë euro (si humbje e porealizuar) dhe nëse i përjashtojmë këta dy zëra rezultati financiar mbetet pozitiv prej rreth 2.518 milion euro.

21. Neto të hyrat nga kamatat

	30 shtator 2020	30 shtator 2019
Të hyrat nga kamata		
Prej afatizimeve në plasmanë	26,866.54	159,312.83
Prej letrave me vlerë	1,901,633.17	1,398,483.53
Prej depozitave me llogaritë me FMN (DST/SDR ne posedim)	110,909.47	516,721.91
Prej normave negative në depozita ³	747,560.20	464,918.16
	2,786,969.38	2,539,436.43
Shpenzimet e kamatave		
Ndaj llogarive me FMN (DST/SDR të alokuar)	121,990.95	547,476.67
Ndaj bankave korrespondente	513,706.35	516,644.42
Prej afatizimeve në plasmanë ⁴	2,294.44	-
Nga huazimi/et	12,682.44	11,678.44
	650,674.18	1,075,799.53
Neto të hyrat nga interesi	2,136,295.20	1,463,636.90

Sic mund të vërehet nga tabela nën shënimin 21 të hyrat nga kamatat janë realizuar më shumë krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar, kryesisht të ndikuara nga realizimi i mirë i të hyrave nga interesi prej letrave me vlerë. Shpenzimet nga kamata po ashtu janë dukshëm më të ulëta se periudha e njëjtë e vitit të kaluar. Të dy këta komponentë kanë bërë që neto të hyrat nga kamata janë më të larta se në periudhën e njëjtë të vitit të kaluar.

Norma mesatare e kamatës për neto të hyrat nga kamatat (duke marrë në konsideratë vetëm portfolion e angazhuar) për periudhën raportuese është rreth 0.358% (në periudhën e njëjtë të vitit 2019 ka qenë rreth 0.231%).

22. Neto të hyrat nga tarifat dhe ndalesat në shërbime

	30 shtator 2020	30 shtator 2019
Të hyrat nga tarifat dhe ndalesat		
Nga depozitat/tërheqjet në para të gatshme	692,280.78	659,844.44
Nga transferet hyrëse	57,607.03	58,115.32
Nga transferet dalëse	219,512.48	248,235.14
Nga transferet vendore (<i>Sistemi i pagesave vendore</i>)	801,643.08	894,029.15
Nga sistemi i regjistrimit të kreditëve	92,838.90	150,877.30
Të hyra nga tarifa tjera	14,509.00	20,955.00
	1,878,391.27	2,032,056.35
Shpenzimet nga tarifat dhe ndalesat		
Prej transportit të parasë së gatshme	240,049.91	357,443.59
Nga transaksionet me banka korrespondente	8,699.86	10,280.80
Prej shërbimeve të pagesave përmes SNP	-	-
	248,749.77	367,724.39
Neto pozicioni nga tarifat dhe ndalesat	1,629,641.50	1,664,331.96

³Duke ju referuar normave negative që po përcjellin tregjet financiare të valutës euro, bazuar edhe në normat referente të BQE (ECB), BQK ka vendosur norma negative në disa nga depozituesit e saj që nga shtatori 2016.

⁴Afatizim plasmani me normë negative.

Të neto pozicioni për të hyrat nga tarifat dhe ndalesat vërehet një rënje e lehtë (pasi paralelisht kanë rënë si të hyrat ashtu edhe shpenzimet) krahasuar me 30 shtator 2019. E rrjedhe kryesisht nga ndryshimet në volum të aktivitetit për zërat e shpalosur në kuadër të grupit.

23. Të hyrat nga aktiviteti rregullator

	30 shtator 2020	30 shtator 2019
Nga mirëmbajtja e licencave të bankave	2,392,943.40	2,120,307.55
Nga licencat prej institucioneve bankare	9,900.00	31,700.00
Nga mirëmbajtja e licencave të kompanive të sigurimeve	933,610.64	918,744.87
Nga licencat prej kompanive të sigurimeve	24,650.00	69,200.00
Të hyrat nga aktiviteti rregullator i fondeve pensionale	20,063.44	19,442.25
Nga aktiviteti rregullator i institucioneve tjera financiare (jobankare)	201,794.21	197,789.49
Gjithsej	3,582,961.69	3,357,184.16

Ndryshimi si rritje krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2019, e rrjedh kryesisht nga ndryshimi në volumin e aktivitetit dhe pjesërisht nga ndryshimi i tarifave në korrik 2019.

24. Të hyrat nga grantet

	30 shtator 2020	30 shtator 2019
Të hyrat nga grantet	94,206.93	86,356.87

Dy janë grantet që për nga pesha e dominojnë zërin nën shënimin numër 24. Ato janë: granti për sistemin e menaxhimit të gjithë procesit të *emetimeve të letrave me vlerë të Qeverisë* (ku i gjithë sistemi është dhënë si grant BQK-së nga Thesari - Ministria e Financave dhe granti për *sistemin e mbikëqyrjes financiare*.

Ndërsa grantet për financim të trajnimeve dhe zhvillim të personelit (financuar nga ECB-Bundesbank) dhe ai i studimit të fizibilitetit për qendër të trajnimeve ka peshë shumë më të vogël.

25. Të hyrat tjera operative

	30 shtator 2020	30 shtator 2019
Të hyra tjera	6,450.26	2,927.55

Ky grup përbehet nga të hyra prej aktiviteteve jo të zakonshme të BQK-së dhe të cilat nuk kanë mundur të klasifikohen në zërat specifikë të të hyrave. P.sh. shitja e tokenëve që përmbajnë certifikata për qasje në sistem Depo-x, për klientët shfrytëzues të sistemit në fjalë, kryesisht ndaj bankave komerciale dhe të ngajshme.

26. Shpenzimet e personelit

	30 shtator 2020	30 shtator 2019
Shpenzimet e pagave dhe kompensimeve	2,534,825.37	2,459,657.97
Shpenzimet e kontributeve dhe sigurimi shëndetësor	567,239.06	541,825.95
Shpenzimet e trajnimeve	24,396.37	80,775.35
Shpenzimet për Bordin e BQK-së	62,656.33	85,047.96
Shujta ditore	110,313.00	101,059.50
Shpenzime tjera	13,360.17	18,454.18
Gjithsej	3,312,790.30	3,286,820.91

Gjithsej numri i të punësuarve që kanë qenë aktivë në listën e pagave gjatë periudhës janar-shtator 2020 është: 229 (në periudhën janar - shtator 2019, 229).

Në kategorinë *tjera të shpenzimet e personelit* përfshihet *kompensimi shtesë pensional (2020, 8,100.37 euro; 2019, 8,100.39 euro)*, *mbështetja financiare për strehim (2020, 5,259.80 euro; 2019, 5,782.29 euro)* dhe *programi i praktikës së studenteve (2020, 0.00 euro; 2019, 4,571.50 euro)*. Kompensimi shtesë pensional është rrjedhojë e vendimeve të mëhershme, nga ku disa ish punëtorë kompensohen drejtpërdrejt nga BQK-ja, në pamundësi për bartjen e këtij detyrimit ndaj tyre të fondet pensionale në momentin kur BQK-ja ka bartur menaxhimin e fondit shtesë pensional.

27. Shpenzimet e përgjithshme dhe administrative

	30 shtator 2020	30 shtator 2019
Shpenzimet e sigurimit	226,241.00	234,361.49
Riparime dhe mirëmbajtje	46,722.15	49,198.70
Mirëmbajtje të aplikacioneve	287,588.15	241,865.67
Shpenzime komunikimi (telefoni, fax-i dhe interneti)	16,533.62	18,036.97
Shpenzimet e shërbimeve publike/komunale	51,591.46	54,086.06
Shpenzimet e jashtme dhe të auditimit	9,663.33	9,379.80
Shpenzime të sigurimit fizik (te objektit)	65,354.40	55,310.40
Udhëtimet dhe transporti	13,363.22	108,359.82
Shpenzimet operative të automjeteve	10,842.86	11,865.20
Material shpenzues administrativ	17,582.55	15,762.85
Shpenzimet e bufësë (për kafe ndaj personelit dhe takime të ndryshme)	21,399.42	27,812.31
Shpenzime për furnizime (për pajisje të TI dhe jo TI)	10,208.52	14,789.97
Publikimet dhe literatura	4,534.56	8,483.06
Shpenzimet e përfaqësimit	9,920.88	23,124.91
Tarifa anëtarësimi në institucione profesionale ⁵	19,995.43	20,811.88
Tjera ⁶	38,256.93 ⁷	17,988.11
Gjithsej	849,798.48	911,237.20

⁵ Në kuadër të kategorisë “Tarifa anëtarësimi në institucione profesionale” kryesisht janë këto: *Anëtarësimi në Shoqatën ndërkombëtare të sigurimeve (IAIS)*, *Shoqatën ndërkombëtare të pensioneve (IOPS)*, *Shoqatën ndërkombëtare të regjistrit të kreditëve (ACCIS)*, *Institutin për auditim të brendshëm (IIA)* dhe *Bordin për standarde të raportimeve financiare (IASB-IFRS)*.

⁶ Në kuadër të kategorisë “Tjera të shpenzimet e përgjithshme dhe administrative” për periudhat raportuese janë të përfshira: *gardërobë pune rreth 7,426.77 euro (2020)* dhe *7,203.76 euro (2019)*; *shtypi ditor 714.80 euro (2020)* dhe *596.30 euro (2019)*; *shpenzime operative për kartelat bankare dhe vlerat e shlyera 2.60 euro (2020)* dhe *3.80 euro (2019)*; *shpenzime të jashtëzakonshme 26,929.98 euro (2020)* dhe *4,864.19 euro (2019)*; dhe *shpenzimet për parking dhe për aktivitete sportive* (kryesisht terminet për shfrytëzimin e fushave për futboll dhe volejbol) *2,858.17 euro (2020)* dhe *5,320.12 euro (2019)*; *shpenzime tjera 15.00 euro (2020)* dhe *0.00 (2019)* si dhe *shumat e shlyera 309.61 euro (2020)* dhe *-0.06 euro (2019)*.

⁷ Ashtu edhe sikurse por vërehet kemi rritje të konsiderueshme të kategori “Tjera”, por që pothuajse tërësisht rritja i atribuohet shpenzimeve të jashtëzakonshme që hynë brenda kësaj kategorie dhe që rrjedhin nga shpenzimet e aprovuara për masat mbrojtëse nga COVID 19.

Ndryshimet të shpenzimet e përgjithshme administrative janë rrjedhë e aktiviteteve dhe vendimeve operative si dhe pjesërisht nga ndonjë aktivitet që nuk ka pasur periodicitet të njëjtë në periudhat krahasuese. Por që shikuar si tërësi janë brenda trendit të tyre të zakonshëm/planifikuar. Përjashtim këtu kane dy kategori ato të aplikacioneve dhe të tjera. Këto te fundit i shpjegoam të shpalosja me referencë (7), ndërsa të shpenzimet e aplikacioneve rritja rrjedhë nga një nënvlerësim i zërit të mirëmbajtës se një aplikacioni ne vitit 2019 dhe rrjedhimisht ka fryrë shpenzimet ne vitin 2020.

28. Neto rezultati nga ndryshimet e kursit të këmbimit

	30 shtator 2020	30 shtator 2019
Rivlerësimi valutor		
nga zëri/at ne USD	(533,030.99)	467,224.71
nga zërat ne SDR	174,210.14	96,188.04
Neto fitimi/(humbja) e perealizuar (nga ndryshimi i kursit të këmbimit)	(358,820.85)	563,412.75

Rezultati i paraqitur më lartë është i përkohshëm (specifikisht vetëm për datën e raportimit) dhe mund të lëvizë varësisht nga lëvizja e kursit të këmbimit EUR/SDR dhe EUR/USD.

29. Paraja e gatshme dhe ekuivalentet e saj

Shënim		30 shtator 2020	31 dhjetor 2019
Paraja e gatshme	5	274,797,205.58	302,165,654.19
Llogaritë rrjedhëse me bankat jo rezidente	6	189,025,105.74	108,863,319.55
Llogaritë depozituese me bankat jo rezidente dhe me maturitet deri në tre muaj		8,728,403.48	9,079,945.56
Gjithsej		472,550,714.80	420,108,919.30

Paraja dhe ekuivalentët e saj mbahen për qëllim të përmbushjes se detyrimeve të likuiditetit kryesisht afatshkurtër. Një investim kualifikohet si ekuivalent i parasë kur ai ka maturitet afatshkurtër, më pak se tre muaj nga data e blerjes.

30. Detyrimet e pritura dhe kontingjente

Anëtarësimi në Bankën Botërore

Pas anëtarësimit të Republikës së Kosovës në Bankën Botërore dhe nënagjencionet e saj Qeveria e Kosovës ka lëshuar nota të pagueshme (sipas kërkesës) duke u zotuar se do të paguajë sipas kërkesës së Bankës Botërore (nënagjencioneve të saj) për pjesën e tarifës së anëtarësisë. Vlera e tyre më 30 shtator 2020 është rreth 645,152 euro (më 31 dhjetor 2019 ky detyrim i pritshëm ka qenë 645,152 euro), BQK luan rolin e ndërmjetësit financiar (bankës garantuese) dhe mjetet mbahen në llogari nën përkujdesje (garantuese).